

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"I.C.S" sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më datë 11.11.2024, (dymijë e njëzet e katër), unë i nënshkruari i mëposhtëm:

**Elios Duni**, i datëlindjes 11/07/1984, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr. personal I40711084P,

me cilësinë e "Ortakut Themelues", redaktoj këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroj së me vullnet të lire të plote e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet përkatëse, në ligjin "Për QKB", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "I.C.S" sh.p.k.

**KREU I**

**Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "I.C.S" sh.p.k.

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqëria "I.C.S" sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka selinë në, Tiranë, Tiranë, Rruga "Myslym Shyri", Apartamenti nr.34, Godina 6, Hyrja 5, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4**

**Objekti**

Shoqëria ka si objekt kryerjen e te gjitha aktiviteteve që një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryej në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë por pa u kufizuar në:

1. Studimin, projektimim, konsulencen, investimin, financimin, shfrytëzimi dhe/ose administrimi, dhe/ose mirëmbajtje, publike dhe/ose private në fusha të ndryshme, sipërmarrjen zbatuese/shërbyese për realizimin sipas rastit me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave të ndryshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, si:- Investime ne fushën e ndërtimit, ndërtime të objekteve



qytetare, industriale dhe qendra multifunkionale, punime dheu, sistemime, ndërtime pallatesh apo kompleksesh civile, industriale, ekonomike, tregtare, kulturore, sportive, të objekteve sociale, hoteleve, fshatrave turistike, etj. Punime në ndertim, struktural por jo vetëm, armature, suvatime, rifiniturash punime instalatore të natyrës, hidraulike, elektrike, hidro-mekanike, ndërtim muresh, shtrim pllakash lysterje, veshje, fasade, etj. Rikonstruksione të objekteve, mirëmbajtje, projektim në fushën e ndertimit dhe mbikqyrje e kolaudime në perputhje me kategorinë e licenses personale, por edhe me kontroktim apo nënsipërmarrje me subjekte te tjera tregtare te karakterit juridik apo fizik, si dhe cdo aktivitet të fushës së ndertimit.

2 Eksport - import, tregti me shumicë e pakicë të mallrave industriale, makineri e pjesë këmbimi të të gjitha llojeve, paisje elektrike, hidraulike, hidrosanitare, lëndë të para, materiale ndertimi, inerte, produkte të ngjashme etj. Ndertimin e ndërtesave publike, private, rrugëve, urave, mbikalimeve e nënkalimeve, autostrada, vepra te tjera ndertimore të të gjitha kategorive civile, infrastrukture dhe te vecanta; si dhe çdo ndertim tjetër që në përfundim përbën send të paluajtshëm sipas nenit 142 të Kodit Civil për shkak te trupëzimit në mënyre të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën ku është vendosur.

3. Investime ne fushën e pasurive te paluajtshme dhe ndertimit; Projektim, mbikëqyrje dhe zbatim i punimeve ndertimore te çfarëdolloj. Ofrimi i shërbimeve te konsulencës ne fushën e menaxhimit te projekteve dhe marketimit te pasurive te paluajtshme; Ndertime dhe rikonstruksione te objekteve civile, industriale, tregtare, turistike, shëndetësore, kulturore, sportive, vepra te kullimit per vaditje, infrastrukture, shërbime komunale e urbane, ndërtime rrugore e hekurudhore, projektme te objekteve te sipërtreguara. Blerje dhe shitje, dhënie dhe marrja me qira trojesh, ndërtesa dhe pasuri te paluajtshme.

4. Tregtimin dhe import-eksportin me shumicë e pakicë, të të gjithë mallrave te gatshme dhe gjysëm të gatshme me ose pa akcizë, tregtimin me shumicë apo pakicë te mjeteve dhe mallrave që operojnë në fushën e ndertimit pa rënë ndesh me legjislacionin e Republikës se Shqipërisë.

5. Implementimi i projekteve te hoteleve, fshatrave turistike, resorteve qendra turistike e të tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve të nevojshem në funksion te tyre.

6. Aktivitet ne fushën e mjedisit për mbrojtjen dhe/ose përmirësimin si dhe rehabilitimin e kushteve të mjedisit rrethues; perpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjetër.

7. Blerje dhe shitje, dhënie dhe marrja me qira trojesh, ndërtesa dhe pasuri te paluajtshme.

Shërbime marketing, marrëdhënieve me publikun, ekspertizë shitje, menaxhimi i pronës, ndërmjetësim qiradhënie, shërbime të studimit të tregut, shërbime të pas shitjes, ndjekja e pagesave të klientëve, mbajtja dhe menaxhimi i data bazës së klientëve, mbajtja e marrëdhënieve me klientët. Shoqëria mund të kryej çdo operacion tregtar, e që lidhen me pasuri të luajtshme dhe te paluajtshme; operacione financiare dhe kredi marrje, të japë garanci të tretëve, si edhe të blejë dhe shes, ose marr me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume të themeluara apo në themelim e sipër që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, por gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.

8. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim, aktivitet apo operacion ndihmes tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues dhe/ose te nevojshem ndaj përmbushjes së objektit kryesor të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim me objektin e Shoqërisë, dhe cdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprures dhe ne interes të shoqërisë.

#### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.



**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë** dhe është i përbërë nga **1 kuote**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, në 1 kuotë me vlerë, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaku i shoqërisë si më poshtë:

- 1- **Elios Duni**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 100 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**


**Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;



- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 9**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, qe janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 10**

### **Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. **Elios Duni** i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë **5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jenë të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët mund të përfaqësojnë shoqërinë së bashku ose veç njëri nga tjetri dhe mund të prokurojnë të tretë për përfaqësim të tyre. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## **Neni 11**

### **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë asamblesën e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe,
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon së të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin së vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## **Neni 12**

### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 13**

### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

#### **Neni 14**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 15**

##### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **Neni 16**

##### **Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 2 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare, nënshkruan në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

**ORTAKU I SHOQËRISË**

**ELIOS DUNI**

*Elios Duni*